

Dashnor Kaloçi

**K**a qenë e djela e fundit e muajit gusht të vitit 1990-të, kur në një cep të gazetës letrare "Drita", një poezi e fare e shkurtër e titulluar "Kuajt", tërhoqi vëmendjen e lexuesëve të shumë dhe bëri një bujë të jashtëzakonshme aq sa tirazhi i madh i gazetës së njohur u përpi brenda ditës. Po ç' ishte ajo poezi, kush ishte autori i saj e ç' farë thuhej aty në ato pak rreshta që njerëzit e shumë filluan ta kopjojnë e ta shpërndajnë fshehurazi me njeri-tjetrin nëpër copa letrash, ndonëse ajo ishte e botuar në shtypin zyrtar? Në Beograd ambasadori amerikan më pyeti: A ke prova se je kundër komunizmit?

Në çast përkthyesi nxorri e përktheu poezinë time "Kuajt". Pas kësaj fjalët e para dhe të fundit që nxorri ambasadori amerikan ishin: Paç fat në Amerikë, bir". Gjek Marinaj i vendosur në Richardson të Tekxasit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku jeton që nga viti 1990 kur u arratis nga Shqipëria pas botimit të poezisë së famëshme, rrëfen për "Gazetën" gjithëshka nga ajo ngjarje e largët e dhjetë viteve të shkuara kur ato pak vargje vunë në përshtjellim deri majën e piramidës së shtetit komunist të asaj kohe, për të ndëshkuar redaksinë e "Dritës" dhe vetë atë autorin rebel që guxonte të shkruante: / Po ishim dhe mbetëm kuaj para njeriut /

### Gjek Marinaj: Ne flinim pa bukë

Ai jetonte së bashku me familjen e tij në një fshat të thellë të Malësisë Madhe të quajtur Brrut. Nuk i dihet edhe sa do të qëndronte në atë fshat me ato pak shtëpi, sikur në gushtin e vitit 1990, të mos i ishte botuar ajo poezi që i ndryshoi krejtësisht rrjedhën e jetës tij. Familja e Gjekës si shumë familje të tjera, jetonte në një varfëri të thellë. Lidhur me gjendjen në të cilën ndodhej asokohe, Gjeka kujton: "Babai dhe nëna ime për vetë kushtet që kishim me një arsim minimal, ishin të detyruar që ti përvisheshin punës fizike për të na rritur ne shtatë fëmijëve që ishim rradhë njeri pas tjetrit. Shtëpia jonë ashtu si të gjitha shtëpitë e Brrutit ishte krejt e vjetër dhe nga që ishim shumë fëmijë, babai kishte filluar që të ndërtonte një shtëpi të re për të na e ndryshuar sadopak jetesën. Por kjo gjë ishte shumë e vesh-


tirë për të, pasi jo vetëm që nuk kishim para, por në fshatin tonë nuk gjendeshin fare materiale ndërtime. Kështu babai kur kthehej nga Hoti ku punonte në Bonifikim, sillte gjithmonë me vete një thes me rërë që e mbante në kurriz gjithë rrugën. Pasi e linte thesin, para se të flinte shkonte e punonte edhe dy orë të tjera duke thyer gurë që na duheshin për shtëpinë e re. Po kështu nëna nga ana tjetër robtohej akoma më shumë. Ajo zgjohej që me natë dhe pasi gatuante diçka për ne dhe për babain shkonte në punë në kooperativë, nga ku kthehej vetëm në darkë me një barrë dru në shpinë. Ajo kurrë nuk kishte kohë për të pushuar, pasi lante rrobat tona, punonte në atë pak kopësht personal që kishim dhe ndihmonte babain në ndërtimin e shtëpisë së re. Megjithatë ata bënë gjithë ato punë çfilitëse dhe mbytëse, ne shpesh herë na mungonin lekët për të blerë bukë. Kështu mbaj mend që njeriu i cili binte bukë të ngarkuar në kosha mbi mushka e gomerë, sa herë thërriste me të madhe: Oooo Nik Marinaj! Nëse i ke lekët hajde e merre bukë. Ai zë shpesh herë më tingëlonte i keq, sepse jo rrallë na mungonin lekët dhe ato mushka të ngarkuara prisnin më kot nga ne shtatë fëmijët që flinim pa ngrënë darkë. Prindërit në vazhdim të përpjekjeve të tyre për të na e rregulluar disi jetesën, vendosën dhe u shpërngulën për në fshatin Bajzë. Po ashtu dhe aty ku shkuam, jetesa jonë nuk pati asnjë ndryshim nga Brruti ku jetonim më parë, përfundon Gjeka përshkrimin me nota rënkthëse për gjendjen në të cilën ndodhej familja e tij."

# Gjek Marinaj, po kapërceu Atlantin

*Nasi Lera: Të nesërmen më të se çfarë kishim bërë me atë p*

### I dhënë pas poezisë

Ndonëse jetonte në një gjendje të mjeruar, Gjeka kishte si pasion librat e lexonte shumë si letërsinë shqiptare dhe atë të huaj. Lidhur me këtë gjë ai kujton: "Shumë parë se të filloja të shkruaja poezi, kam filluar të lexoj letërsi, e kryesisht poezi. Nga leximi i letërsisë dhe i poezisë në veçanti më lindi dëshira për ta kultivuar në gjininë e poezisë. Jo vetëm për të shkruar poezi, por dhe për ta lexuar atë shpesh herë jam ndëshkuar si nga prindërit ashtu dhe nga shoqëria. Më kujtohet si sot kur në vitin 1981 pati dalë botimi i tretë i romanit të Ismail Kadaresë "Dimri i Madh" dhe unë i kërkoja lekë nënës që ta bleja atë. Tamam në atë kohë babai im ishte shtruar në spital dhe nëna nuk kishte lekë që të më ndihmonte ta bleja atë libër. Unë si i marrosur që isha pas Ismail Kadaresë dhe i vendosur për ta blerë atë libër, bëra një plan i cili do të më krijonte mundësinë ta mbyllja atë problem. Kështu fshehurazi nënës, hapa dyshekun në të cilin flija dhe nxorra leshin e deleve të shprishur që ishte aty. Pas kësaj në vend të leshit, futa aty disa troba të vjetra të vëllezërve e motrave të mija. Pas kësaj shkova në dyqanin e fshatit e shita leshin dhe me ato para që fitova munda që ta blej librin e Kadaresë. Të nesërmen gjithë ditën unë e lexova librin në këmbë, pasi nuk mund të ulla në karrige nga vrugat e thuprës që më kishte rehatuar nëna, pasi e kishte pikasur paudhësinë time. Njëherë tjetër kur nuk isha më shumë se 11 vjeç, kishte mikun e tij shkrimtarin Rudolf Marku, i cili duke parë talentin që kishte, mundoi që ti botonte ndonjë cikël poetik. Po si arriti që të botohej ajo poezi në faqet e "Dritës" ku asokohe dhe shumë poetë të tjerë e kishin ëndërr një gjë të tillë? Lidhur me këtë shkrimtari




Gjekë Marinaj, Dallas 1995

preteksin se nëna ime kishte nevojë për disa lekë, e shita tek një fshatar tjetër dhe kështu munda që të siguroj lekët për librin. Për mua poezia është gjinia më superiore e artit. Vetëm në poezi mund të gesh një përbërje të përbashkërt gjennale të arteve në një trup e shpirt të vetëm poetik: muzikalitetin imagjinues të një kompozitori, imazhin mediativ të një piktori, prozën e kondësuar të një romancierit, dramën vibruese të një dramaturgu e medikamentin shpirtëror të një lexuesi. Në një farë mënyre unë jetoj për të lexuar e krijuar poezi."

### Nasi Lera: Ja si i botuam "Kuajt"

Me një tufë poezish në xhep, Gjek Marinaj shpesh vinte në Tiranë e takohej me mikun e tij shkrimtarin Rudolf Marku, i cili duke parë talentin që kishte, mundoi që ti botonte ndonjë cikël poetik. Po si arriti që të botohej ajo poezi në faqet e "Dritës" ku asokohe dhe shumë poetë të tjerë e kishin ëndërr një gjë të tillë? Lidhur me këtë shkrimtari

Nasi Lera kujton. Gjekën e kam njohur aty nga pranvera e vitit 1990-të, kur vinte tek redaksia e gazetës "Drita" për të botuar ndonjë poezi. Ai ishte një djalë mjaft i edukuar dhe tepër i talentuar në poezi. Kur po pinim një kafe tek klubi i Lidhjes Shkrimtarëve, Gjeka më dha një cikël me poezi që t'ja shikoja. Pas pak na erdhi në tavolinë dhe Ndoc Gjetja të cilin pasi e prezantova me Gjekën, i thashë që ti botonte një cikël, duke i bërë dhe një paraqitje të shkurtër, meqë ishte autor i ri e botonte për herë të parë. Ashtu siç biseduam, Ndoci i botoi Gjekës një nga ato poezi që atij i kishte pëlqyer më shumë e cila titullohej "Kuajt". Nuk e mbaj mend mirë të hënën apo të martën sapo shkova në zyrë më morën në telefon nga Komiteti i Partisë i Tiranës dhe më thanë se çfarë ishte ajo poezi që kishim botuar në gazetë e kush ishte autori i saj. Unë ju përgjigja se ai ishte një djalë i ri nga Kopluku dhe shumë i talentuar e meqë në punonte në fshat me kuaj, ishte shumë



Gjeka në shtëpinë e tij në Rie

i dashuruar pas tyre dhe ju kishte kushtuar një poezi. Nga ana tjetër e telefonit më thanë se ajo gjë nuk ishte ashtu siç po jua shpjegoja unë, sepse nga Shkodra ku ishte bërë problem i madh, ishte interpretuar ndryshe. Ata kishin telefonuar dhe ju kishin thënë se ai me kuajt personifikonte turmat e njerëzve. Unë ju përgjigja se për atë poezi, ai ishte mendimi im. Nuk e di se ç'farë ndodhi më pas me Gjekën, por mora vesh se ai kishte pasur probleme në Shkodër, ku ajo poezi kishte bërë bujë të madhe dhe ai ishte arratisur."

### Gjeka: Ja pse u arratisa

Botimi i poezisë "Kuajt", pati një jehonë mjaft të madhe sepse aty aludohej hapur kundër sistemit totalitar komunist. Lidhur me këtë gjë Gjeka kujton: "Disa ditë pas botimit të poezisë më 11 shtator 1990-të, më erdhi një letër nga Dega e Brendëshme e Shkodrës, ku njoftohesha të paraqitesha aty të nesërmen më datë 12 në ora 8.00. E kisha krejtë qartë se pse më kërkonin në Degë dhe vendosa që të arratisesha nga Shqipëria, duke ja mbathur kufirit për në Jugosllavi e më pas drejt Amerikës. Mendimin për tu arratisur, unë e kisha pasur që përpara aty nga viti 1989, (për tu përgatitur zbrisja çdo ditë në Shkodër duke bërë stërvitje me

### Ofertë pune

Kërkohet një inxhinier ndërtimi që të jetë i pajisur me licencë dhe të zotërojë gjuhën angleze.

Tel. 241 942



otoi në gazetën "Drita" poezinë e famëshme e cila e detyroi të merrte rrugën në drejtim të kufirit

# eti që në 1990-ën ikun me "Kuajt"

lefonuan nga lart dhe më thanë  
poezi që njerzit i quante kuaj



ardson të Texasit, shtator 2000

ekipin e atletikës së VI-laznisë) por ajo letër e Degës së Brendëshme ma shpejtoi atë. Për vendimin që mora, bisedova vetëm me kushëririn tim Tonin Marinaj, që më së shumti e kisha shok të ngushtë ngaqë ishte djalë tepër besnik dhe me të bisedoja gjithshka. Kështu natën e 12 shtatorit u nisa në drejtim të Rrapshit të Hotit në një lugine ku jo shumë kohë më parë rojet e kufirit kishin vlarë tre shokë të mij që kishin tentuar të arratiseshin. Atë ditë me vete kam marrë vetëm një

çantë ku kisha disa libra me poezi dhe një batanije që do ta hidhja mbi telat e klonit. Si i ri që isha dhe i marrosur pas poezisë, atë natë kur u nisa në drejtim të kufirit mendova se po të vritesha, të nesërmen do takoja Migjenin, Mjedën e ndoshta Pablo Nerudën. Po të më kapnin do të thoshte se do të gjendesha në Degën e Brendëshme pak para orës 8.00 të mëngjezit të 12 shtatorit që më kishin caktuar ata. Kur kapërceva telat e klonit e u largova disa hapa, kam dëgjuar breshëri

të shumta armësh të ushtarëve të kufirit që si duket kishin parë batanijen time mbi telat e klonit. Në Titograd më mbajtën 15 ditë në burg për shkelje kufiri dhe më pas më dërguan në Beograd ku kishte shumë shqiptarë të tjerë dhe midis tyre shumë intelektualë që ishin arratisur nga Shqipëria dhe prisnin aty për të marrë azilin politik drejt perëndimit. Në Amerikë kam mbërritur në 16 shtator të 1991-it. Përpara nisjes, në Beograd, kur mora statusin e azilantit politik, ambasadori amerikan më pyeti: A ke prova që je kundër komunizmit? Në çast përkthyesi i lexoi poezinë time "Kuajt". Pas asaj, fjalët e para dhe të fundit që ambasadori amerikan nxorri nga goja, ishin: Paq fat në Amerikë, bir.

**Rudolf Marku:**

**Atë poezi do ta dëshironte kushdo**

Një nga njerzit që e ka afruar Gjekën për talentin e tij, është dhe shkrimtari, poeti dhe publicisti i njohur Rudolf Marku i cili prej

vitesh jeton në Londër. Në lidhje me poezinë e famëshme "Kuajt" dhe vetë Gjekën ai shprehet: "Fati e desh që Gjek Marinaj të bëhej i njohur vetëm me atë poezi të botuar në një cep të gazetës "Drita", shumë e shumë më tepër nga autorët voluminozë, të cilët kishin vite që botonin e lavdëroheshin pa i lexuar kush. Ishte viti 1989 a ndoshta 1990. Ishte viti kur njerzit përjetonin një atmosferë mbytëse, absurde, fyese, groteske. Në Shkodër trupat e të vvarëve në kufi i tërhiqnin zvarrë përpara syve të shqyer të njerëzve. Turmat rrinin në rradhë me shpresë se mund të blihej një shishe qumësht. Nëpër trena, gjatë udhëtimit, njerëzit shkullnin drasat e dyshemesë e ndiznin zjarre. Çdo gjë dukej se ishte kundër letërsisë e poezisë. Të zënë me preokupimet më banale të jetës, dukej se kujtimi i poezisë, i fantazisë, i ndjenjave, i fyente njerzit. Çuditërisht në këtë atmosferë aq të kobtë, njerzit thërrisnin në ndihmë poezinë. E vetmja rradhë që nuk i fyente njerzit ishte

## "Kuajt"

Tërë jetën duke vrapuar rrimë  
Shohim veç përpara  
Ç' bëhet prapa s' duam t' ia dimë.  
Ne nuk kemi emër  
Të gjithëve kuaj na thonë.  
Nuk qajmë,  
Nuk qeshim,  
Heshtim,  
Dëgjojmë,  
Hamë atë ç' na japin,  
Ecim nga na thonë,  
Asnjë nga ne s' është mendjehollë.  
Kush qe kalë mbreti,  
Posti qe i lartë  
Kush qe kalë princeshe  
I bënë shalë të artë  
Kush qe kalë fshatari  
Pat samarë me kashtë  
Kush qe kalë i egër  
Tërë natën fjeti jashtë.  
Po qemë dhe mbetëm kuaj, para njeriut!

Gazeta "Drita" Gusht 1990

pritja për të blerë gazetën e shkrimtarëve. Dhe po në atë gazetë në një cep të saj, lexuesit e vëmendshëm vunë re një poezi të titulluar "Kuajt" dhe emëri i autorit quhej Gjek Marinaj. Poezia pati një jehonë të jashtëzakonshme. Nëpër trenat e djegur ku kishin mbetur vetëm skeletet metalike njerzit nxirrnin nga xhepi një letër të zhubrosur ku ishte kopjuar poezia "Kuajt". Ajo ishte një poezi e shtruar në mënyrën më naive, me një shkujdesje ritmike dhe e paorganizuar deri në fund. E megjithatë fatin e saj do ta kishin dëshiruar edhe poezitë më të qëndrueshme antologjike. Poezia "Kuajt" i krijoi telashe të papritura autorit njëzetvjeçar. Dikush më tha se Gjekën e arrestuan... Më pas mora vesh arratisjen e Gjekës, ku në kalvarin e saj kishte pasur me vete dhe dy libra poetikë."

**Shkëlqimi i Gjekës në SHBA**

Që prej vitit 1991 kur Gjekë arriti në SHBA, ka

punuar fillimisht shitës në një dyqan e më pas ka mbaruar Institutin Mjekësor ASPT. Në vitin 1994 është punësuar si Phelebatomist pranë Baylor Medical Center. Në pranverën e këtij viti ka mbaruar Kolegjin BROOKHAVEN për shkencat e përgjithëshme. Po kështu aktualisht vazhdon vitin e tretë në Universitetin e UTD, për artet dhe letërsinë botërore me nëndegë gazetarinë. Më 26 nëntor 1999, në një konkurs ndërkombëtar të poezisë që organizohet çdo vit nga universitetet amerikane ka fituar çmimin "Pena e Artë". Gjekë ka shkruar disa libra e vazhdon të shkruaj përsëri kryesisht poezi. Eshhtë botuar gjithashtu në vitin 1998 dhe në Antologjinë "BEST POEMS" ku përfshihen poezitë më të mira të viteve 90-të. Gjek Marinaj është botues i gazetës "KOHA E POETËVE" (shqip-anglisht) dhe ka hapur Shtëpinë Botuese "MARINAJ PUBLISHING" ku kanë botuar librat e tyre disa nga penat e njohura të disaporës shqiptare në SHBA.



**unicef**

**THE UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)  
HAS VACANCY FOR THE FOLLOWING POSITIONS:  
VACANCY Nbr. 01 - Project Assistant**

**Major Duties and responsibilities:**

- Assist Project Officers in the Social Policy and Communication for Development section to prepare documents for the Situation Analysis of children and women, Country Programme documentation, donor reports and proposals, Annual Report, annual Plans of Action, sector workplans. Prepare tables and graphs, collect information, draft routine correspondence. Provide computer inputs, filing and other clerical support.
- Undertake field visits to assist in ongoing monitoring of projects and prepare field trips reports. Assist in planning and organization of training, information and social mobilization programs.
- Coordinate with the Operations/Supply support staff on supply and non-supply assistance activities. Monitor project activities by reviewing a variety of records including project plans, progress reports, inputs, budget and financial expenditure reports. Draft programme budgets.

**Minimum Requirement:**

- Tertiary degree or certificate preferably in the social sciences.
  - Six years progressive experience in technical or administrative clerical work in social sector or related fields. Experience working in international organizations desirable as well as data collection and analysis.
  - Excellent command (understanding and expression) of Albanian and English, in both oral and written form. Capacity to work in team spirit in a multi-cultural environment.
  - Ability to set up computerized data collection, processing, compilation and monitoring system, and analyze output for use by others. Communication, analytical and training skills.
- UNICEF is a smoke free environment.  
Please do not apply if you do not meet the minimum requirements.  
Application forms can be obtained at UNICEF office "Rr. Arben Broci" No. 6, from 9 am to 5 pm. Once duly filled, forms should be returned to UNICEF in a close envelope with the number of the vacancy on the top, **not later than 16 October 2000.**